

Spirit Travel & Tours Sh.p.k

**Pasqyrat financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Përmbajtja

RAPORTI AUDITUESIT TE PAVARUR.....	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE.....	4
1. Informacion i pergjithshem	5
2. Permbledhje e politikave kryesore kontabel.....	5
3. Politikat kontabel.....	6
4. Mjete monetare	9
5. Llogari te arketueshme tregtare.....	9
6. Palet e lidhura	10
7. Te tjera llogari te arketueshme	11
8. Parapagime dhe shpenzime të shtyra.....	11
9. Aktive afatgjata materiale.....	11
10. Qirate financiare dhe hua afatshkurtra.....	12
11. Llogari të pagueshme tregtare	12
12. Detyrime tatimore.....	12
13. Të tjera detyrime.....	13
14. Totali i të ardhurave nga shfrytezimi, neto	13
15. Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	13
16. Shpenzime financiare	13
17. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	14
18. Angazhime dhe pasiguri	14
19. Ngjarje te mepasshme.....	14



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për ortakët e shoqërisë Spirit Travel & Tours shpk,

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Spirit Travel & Tours shpk (më poshtë “Shoqëria”) që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2016, pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabile dhe informacione të tjera sqaruese, të përfshira nga faqja 5 deri në faqen 14.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Spirit Travel & Tours shpk paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2016, të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur dhe ndryshimeve në kapital në atë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Vijimësia

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur me parimin e vijësisë. Përdorimi i këtij parimi të kontabilitetit është i përshtatshëm përveç rasteve kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë Shoqërinë apo të ndalojë veprimtarinë e saj, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër. Si pjesë e auditimit tonë ne kemi arritur në konkluzionin se përdorimi i parimit të vijësisë nga drejtimi është i drejtë. Drejtimi nuk ka identifikuar ndonjë pasiguri materiale që mund të ngrejë dyshime mbi aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijësi, dhe për rrjedhojë nuk ka përfshirë ndonjë rast të tillë në shënimet e pasqyrave financiare. Bazuar në auditimin tonë të pasqyrave financiare, as ne nuk kemi identifikuar ndonjë pasiguri materiale. Megjithatë, as drejtimi dhe as audituesi nuk mund të garantojnë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijësi.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimit apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuideojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontroleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Date 18 Mars 2017



Ilir Binaj CPA, CGMA, Auditor Ligjor



TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**Më 31 dhjetor 2016**

Aktive afatshkurtra	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare	4	3,967,232	2,876,638
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	47,566,582	21,849,098
Llogari të arkëtueshme nga palet e lidhura	6	1,647,850	1,666,300
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	13,782,228	12,525,456
Parapagime dhe Shpenzime të shtyra	8	4,943,498	5,276,673
Total Aktive Afatshkurtra		71,907,390	44,194,165
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	6,771,394	7,819,226
Aktive afatgjatë jomateriale	9	639,268	-
Total aktive afatgjatë		7,410,662	7,819,226
Total Aktive		79,318,052	52,013,391
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Qirata financiare dhe hua afatshkurtra	10	3,443,728	944,213
Llogari të pagueshme tregtare	11	41,768,922	9,501,770
Të tjera të pagueshme ndaj palëve të lidhura	6	5,689,244	12,677,669
Detyrime tatimore	12	303,980	579,894
Të tjera detyrime	13	5,018,303	7,324,613
Total Detyrime afatshkurtra		56,224,177	31,028,159
Detyrime afatgjatë			
Qirata financiare	10	3,503,573	4,524,267
Total detyrime afatgjatë		3,503,573	4,524,267
Totali i detyrimeve		59,727,750	35,552,426
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		16,466,935	16,466,935
Fitime/(humbje) të mbartura		(5,970)	30,848
Fitimi i ushtrimit		3,129,337	-36,818
Total kapitali themeltar		19,590,302	16,460,965
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		79,318,052	52,013,391

Këto pasqyra financiare dhe shënimet shoqëruese nga 1 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare, janë aprovuar me 15 Mars 2017 nga drejtimi dhe nëshkruar në emër të tij nga:



Emilia MARA
Financiere

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve	Shenime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	14	34,242,049	15,458,422
Te ardhura të tjera të shfrytëzimit	14	1,512,879	21,189,109
Lenda e parë dhe materiale të konsumueshme		(16,718,412)	(10,639,034)
Te tjera shpenzime	15	(16,718,412)	(10,639,034)
Shpenzime të personelit		(11,593,502)	(23,552,039)
1) Paga dhe shperblime		(10,115,551)	(20,368,716)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur vecmas nga shpenzimet për pension)		(1,477,951)	(3,183,323)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(1,803,612)	(2,301,721)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		(1,048,151)	-
Zhvlerësim i aktiveve financiare dhe investimeve të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare	16	(386,225)	(27,853)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet për t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		(454,008)	(544,040)
2) Shpenzime të tjera financiare		67,783	516,187
Pjese e fitimit/humbjes nga pjesmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		4,205,026	126,884
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	(1,075,689)	(163,702)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(1,075,689)	(163,702)
Fitimi/humbja e vitit		3,129,337	(36,818)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		3,129,337	(36,818)

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapital themeltar	Fitimi/(humbja) i/e pashperndare	Totali
Gjendja më 01 janar 2015	100	16,497,683	16,497,783
Shperndarje e fitimit	16,466,835	(16,466,835)	-
Humbja neto e periudhes	-	(36,818)	(36,818)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	16,466,935	(5,970)	16,460,965
Fitimi i periudhes	-	3,129,337	3,129,337
Gjendja më 31 dhjetor 2016	16,466,935	3,123,367	19,590,302

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shenime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		3,129,337	(36,818)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzimet financiare jomonetare		(291,489)	(6,449)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	1,803,612	2,301,721
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(26,622,631)	(701,689)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		22,696,503	(12,785,681)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		715,332	(11,228,916)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	9	(1,395,048)	(1,676,709)
Te hyra nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	9	-	2,277,253
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(1,395,048)	600,544
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Hua të arkëtuara		2,490,600	-
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	10	(944,146)	(995,137)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		1,546,454	(995,137)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		866,738	(11,623,509)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	4	2,876,638	14,493,698
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		223,857	6,449
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	3,967,232	2,876,638

Shënimet shoqëruese mbi pasqyrat financiare nga 1 në 19 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria Spirit Travel & Tours Sh.p.k. (me poshte referuar si “Shoqeria”) eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me date 3 dhjetor 2013 dhe prane Deges se Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT L32403002P. Shoqeria zoterohet nga ortakët Nertila Kole dhe Dhimiter Tola me pjesemarrje perkatesisht 50% secili ortak ne kapitalin e Shoqerise.

Me 31 dhjetor 2016, vlera e kapitalit themeltar, eshte 16,466,935 Leke, e ndare ne 100 kuota me vlere nominale 164,669.35 Leke per kuote.

Veprimtaria e Shoqerise rregullohet ne perputhje me dispozitat perkatese te Ligjit 9901, date 14 prill 2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, si dhe nga akti i themelimit dhe statuti i saj. Objekti kryesor i aktivitetit te Shoqerise eshte: “Veprimtari turistike si agjensi udhetimi, guide-perkthyes, tour operator, hoteliere, bar-bufe, restaurant, transport udhetaresh e taksi. Supervizim te fluturimeve, sherbimeve aeroportuale, sherbime call center. Ushtrim i veprimtarise se kembimit valuator. Ushtrim i veprimtarise se agjentit te transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjektit financiar jobanke. Shitjen e biletave te transportit ajror”.

Administratori i Shoqerise eshte Znj. Nertila Kole
Selia kryesore e Shoqerise ndodhet ne Sheshi Skenderbej, Pallati Kultures, kati 1re.
Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 dhjetor 2016 eshte 19 (31 dhjetor 2015: 24).

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABEL

2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura me date 15 qershor 2006, te permiresuara dhe te detyrueshme per zbatim per vitin financiar qe fillon me 01 janar 2015, ne perputhje me Ligjin 9228, date 29 prill 2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” te ndryshuar, me ligjin 9477, date 9 shkurt 2006.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike me perjashtim te rasteve kur percaktohet ndryshe, nese ka te tilla.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Leke, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.4 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Shoqerise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne vecanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese shpjeguese te pasqyrave financiare. Perdorimi i vleresimeve kontabel eshte minimal ne keto pasqyra financiare.

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente gjate periudhes per te cilen jane pergatitur keto pasqyra financiare, perveç rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare te paraqitura ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit te perdorura ne konvertimin e aseteve dhe detyrimeve monetare me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 jane:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Leke/Euro	135.23	137.28
Leke/Dollare Amerikan	128.17	125.79

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga llogari te arketueshme, mjete monetare dhe llogari te pagueshme dhe qeraja financiare.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to, perveç siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojne ne shpenzime dhe te ardhura. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiar joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivitet financiar ose kur Shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellime te pasqyres se fluksit te parase, paraja dhe ekuivalentet te saj perfshijne llogarite rrjedhese dhe parane e gatshme ne arke.

Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme (kerkesat e arketueshme) njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjoni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshitësite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose pagesa te vonuara konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.2 Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Qeraja financiare

Qeraja financiare paraqitet me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Ne rastet kur pjese te nje aktivit afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe Shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke marre per baze jeten e dobishme te aktivit duke filluar nga dita kur ai eshte i gatshem per perdorim. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi. Metodat e amortizimit dhe perqindjet perkatese sipas grupeve te aktiveve afatgjata per vitin aktual jane si me poshte:

Mjete transporti	20% mbi vleren kontabel neto
Pajsje informatike dhe software	25% mbi vleren kontabel neto
Instalime elektrike	20% mbi vleren kontabel neto
Mobilje dhe pajisje zyre	20% mbi vleren kontabel neto

3.4 Zhvleresimi

Aktivitet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktiviteti.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase, te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivitetet financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivitetet e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te riskut kreditor.

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.4 Zhvleresimi (vazhdim)

Aktivitet financiar

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar te disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, transferohet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivet financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te Shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla atehere vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktiviteti tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Nje provigjon njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.6 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat jane flukset hyrese bruto te perfitimeve ekonomike lindur ne rrjedhen normale te aktiviteteve te Shoqerise qe rezultojne ne rritje te kapitalit neto gjate periudhes dhe nuk perfshijne rritjet e kapitalit neto ne saje te kontributeve te ortakeve. Te ardhurat perfshijne vleren e drejte te shumes se arketuar apo te arketueshme nga shitja e mallrave dhe sherbimeve ne rrjedhen normale te aktiviteteve te Shoqerise. Te ardhurat nuk perfshijne tatimin e vleres se shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet, nese ka.

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve ne varesi te fazes se perfundimit te transaksionit ne daten e raportimit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

Te ardhurat nga komisionet e shitjes se biletave te transportit nderkombetar

Shoqeria siguron te ardhura nga sherbimet qe jep ne lidhje me shitjen e biletave te transportit nderkombetar nepermjet sistemit BSP te Shoqates nderkombetare te transportit ajror (IATA - International Air Transport Association). Gjithashtu te ardhura te tjera qe Shoqeria siguron edhe nga ndermjetesimi per stafin e shoqerise Blu Panorama si dhe te ardhurat nga sherbimet e supervizimit te fluturimeve etj. E ardhura perbehet nga cmimi i marre per sherbimin e kryer.

3.7 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne fitimet nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe te ardhura te tjera nga interesat e llogarive rrjedhese apo depozitave. Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit per qerane financiare, humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare.

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

4. MJETE MONETARE

Mjetet monetare përfaqësojnë llogaritë rrjedhëse që Shoqëria ka me bankat në Shqipëri si dhe para ne arke ne valute dhe ne monedhe vendase. Më poshtë po ju japim një detajim të llogarive me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Para ne bankë ne monedhe te huaj	3,251,221	2,091,006
Para ne bankë ne monedhe vendase	581,522	166,441
Para ne arke ne monedhe te huaj	35,929	528,749
Para ne arke ne monedhe vendase	98,560	90,442
Totali	3,967,232	2,876,638

5. LLOGARI TE ARKETUESHME TREGTARE

Llogarite e arketueshme perbehen nga vlerat e te drejtave ndaj klienteve te Shoqerise te cilet nuk kane shlyer ende detyrimin deri ne daten e ndertimit te pasqyrave financiare. Me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajimet persa i perket klienteve me te medhenj paraqiten si me poshte:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Air Vallee SPA	4,824,829	-
Hygeia Hospital	2,729,392	3,953,329
Vodafone Albania sha	2,413,661	2,268,023
Philip Morris Albania shpk	2,324,917	2,107,507
Ericsson AB	1,738,762	265,353
Planet	3,363,319	-
Ada Banush	918,544	261,518
Friends Travel	892,112	242,301
Almend Kreku	708,245	-
Salus Tirana	512,024	519,786
Jon Impeks.	495,821	-
Kelvin Andoni	454,946	603,332
Diana Dalipaj	409,163	-
Morena Kushi	397,657	-
JONA TRAVEL & TOURS	397,244	-
Air BP ALBANIA	387,803	-
Kliente te ndryshem	24,598,143	11,627,948
Totali	47,566,582	21,849,098

Kliente te ndryshem perbehen nga nje numer i madh klientesh te rastesishem por edhe nga kliente apo agjente te perhershme te cilet ne fund te periudhes kontabel kane vlera te vogla detyrimi.

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. PALET E LIDHURA

Llogaritë e arketueshme/pagueshme nga palet e lidhura perbehen nga vlerat e te drejtave/detyrimeve ndaj paleve te lidhura te cilet nuk jane shlyer/paguar ne daten e ndertimit te pasqyrave financiare. Per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2016, transaksionet dhe te drejtat dhe detyrimet me palet e lidhura paraqiten si vijon:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura		
Debitor IMS	1,647,850	1,666,300
Total llogari te arketueshme nga palet e lidhura	1,647,850	1,666,300
Llogari te arketueshme tregtare		
IFLY (shenimi 5)	211,839	-
Albawings (shenimi 5)	350,804	148,949
Avioalb Services (shenimi 5)	47,060	-
Totali (shenimi 5)	609,703	130,553
Detyrime ndaj paleve te lidhura		
Kreditore IFLY	4,370,751	6,828,462
Kreditore Avioalb	446,259	-
Kreditore Gentian Kole	-	1,730,807
Kreditore Dhimiter Tola	872,234	4,118,400
Totali	5,689,244	12,677,669
Llogari te pagueshme tregtare		
IFLY (shenimi 11)	1,138,708	-
Avioalb Services (shenimi 11)	197,165	-
Totali (shenimi 11)	1,335,874	-
Te ardhura nga palet e lidhura		
IFLY shpk	216,296	4,010,333
Albawings shpk	4,020,631	172,352
Avioalb Services	1,383,728	782,003
Totali	5,620,655	4,964,688
Shpenzime ndaj paleve te lidhura		
IFLY shpk	4,854,577	-
Albawings shpk	1,153,055	6,945,931
Avioalb Services	201,714	-
Totali	6,209,346	6,945,931

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

7. TE TJERA LLOGARI TE ARKETUESHME

Te tjera te drejta te arketueshme me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 perbehen si me poshte:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Depozite per IATA	7,978,570	6,864,000
Depozite per Blu Panorama	2,028,450	2,059,200
TVSH e arketueshme	2,944,397	2,017,654
Te tjere debitore	781,906	1,008,058
Tatim fitimi i parapaguar	48,905	576,544
Totali	13,782,228	12,525,456

8. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagime dhe shpenzime te shtyra me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 perbehen si me poshte:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Parapagim per Quadlabs	4,398,794	4,317,113
Shpenzime te shtyra	474,665	824,353
Parapagime furnitoresh	70,039	135,207
Totali	4,943,498	5,276,673

9. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Aktivitet afatgjata materiale me 31 dhjetor 2016 perbehen si me poshte:

Kosto	Mjete transporti	Paisje informatike	Istalime elektrike	Mobilje dhe paisje zyre	Software	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	9,497,212	532,335	-	1,718,391	-	11,747,938
Shtesa	-	353,648	363,456	959,605	-	1,676,709
Riklasifikime	-	290,433	-	(290,433)	-	-
Pakesime	-	(723,429)	-	(1,949,727)	-	(2,673,156)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	9,497,212	452,987	363,456	437,836	-	10,751,491
Shtesa	-	548,431	79,496	-	767,121	1,395,048
Gjendja më 31 dhjetor 2016	9,497,212	1,001,418	442,952	437,836	767,121	12,146,539
Amortizimi dhe zhvlerësimi						
Gjendja më 1 janar 2015	(1,006,707)	(19,740)	-	-	-	(1,026,447)
Shpenzimi i periudhës	(1,698,096)	(221,326)	(48,689)	(333,610)	-	(2,301,721)
Riklasifikime	-	19,740	-	(19,740)	-	-
Rimarrje amortizimi	-	129,559	-	266,344	-	395,903
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(2,704,803)	(91,767)	(48,689)	(87,006)	-	(2,932,265)
Shpenzimi i periudhës	(1,358,481)	(175,279)	(69,471)	(72,527)	(127,854)	(1,803,612)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	(4,063,284)	(267,046)	(118,160)	(159,533)	(127,854)	(4,735,877)
Vlera kontabël neto						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	6,792,409	361,220	314,767	350,830	-	7,819,226
Gjendja më 31 dhjetor 2016	5,433,928	734,372	324,792	278,303	639,267	7,410,662

Mjetet e transportit te Shoqerise jane te financuara me qera financiare (shenimi 10).

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

10. QIRATE FINANCIARE DHE HUA AFATSHKURTRA

Llogaria hua afatshkurtra përfshin llogarite për qerata leasing dhe llogarite e kartës së kreditit. Qeraja financiare është marrë për të financuar mjetet e transportit të Shoqërisë (shënimi 9). Vlera totale e detyrimit të mbetur është 51,374 euro ose kundervlefata në lekë prej 6,947,301 lekë (nga e cila 32,956 euro i takon qerave financiare dhe 18,417 euro llogarise të kartës së kreditit), (31 dhjetor 2015: 39,834.50 euro ose kundervlefata në lekë prej 5,468,480 lekë). Ato mbartin një normë interesi fikse prej 9% dhe një detajim i tyre jepet si më poshtë:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Hua afatshkurtra Karta Krediti	2,490,600	-
Qera financiare pjesa afatshkurter	953,128	944,213
Qera financiare pjesa afatgjate	3,503,573	4,524,267
Totali	6,947,301	5,468,480

11. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE

Te pagueshme ndaj furnitoreve përbehet nga vlera e paguar për shërbimet, mallrat, qerata, etj. por të papaguara ende në fund të periudhës. Llogari të pagueshme tregtare (furnitore) më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 përbehen si më poshtë:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Planet SHPK	20,691,111	-
IATA Albania	8,612,071	835,028
Blue Panorama Airlines Spa	2,627,380	1,814,847
IFLY shpk	1,138,708	-
Giorgi Alfo shpk	551,738	-
Grand Korca Shpk	342,398	-
Hotel Splendor	288,309	-
Avioalb Services	197,165	-
ALBDESIGN PSP	132,000	-
Qtzhk Shpk	130,903	540,334
Tivoli Gare Do Oriente	126,575	-
Rinia-04 Shpk	108,864	-
Te tjere furnitore	912,795	600,345
Furnitore fatura të pambërritura	5,908,904	4,879,957
AirValle	-	831,259
Totali	41,768,922	9,501,770

12. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet ndaj organeve tatimore më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 përbehen si më poshtë:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	231,562	411,838
Tatim mbi të ardhurat e personale	70,755	168,056
Tatimi në burim	1,663	-
Totali	303,980	579,894

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

13. TË TJERA DETYRIME

Te tjera detyrime me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 perbehen si me poshte:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Paga e shperblime	-	1,346,495
Kreditore Genti Kole	1,818,150	1,730,807
Blue Panorama	-	1,120,320
Kreditore te tjere	3,200,153	3,126,991
Totali	5,018,303	7,324,613

14. TOTALI I TË ARDHURAVE NGA SHFRYTEZIMI, NETO

Shoqeria siguron te ardhura nga komisionet qe merr per sherbimet qe jep ne lidhje me shitjen e biletave te transportit nderkombetar nepermjet sistemit BSP te Shoqates nderkombetare te transportit ajror (IATA - International Air Transport Association). Gjithashtu te ardhura te tjera qe Shoqeria siguron edhe nga ndermjetesimi per gjetjen e stafit dhe te ardhurat nga sherbimet e supervizimit te fluturimeve etj. E ardhura perbehet nga cmimi i marre per sherbimin e kryer. Vlera e te ardhurave me 31 dhjetor 2016 eshte 34,242,049 (31 dhjetor 2015: 15,458,422 leke). Nje detajim i te ardhures neto te Shoqerise jepet si me poshte:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Vlera e biletave te shitura	873,221,525	434,125,957
Kosto e biletave te shitura	(828,773,028)	(391,282,763)
E ardhura neto (komisioni i agjensise)	44,448,497	42,843,194
Te ardhura te tjera	58,082	-
Shpenzime te rifaturuara	(8,751,650)	(6,195,663)
Totali i te ardhures	35,754,928	36,647,531

15. LENDA E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME

Nje detajim i shpenzimeve te tjera dhe lendes se pare dhe materialeve te konsumueshme jepet si vijon per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Qira per zyra	2,936,851	3,824,761
Shpenzime Karburanti	1,550,761	-
Shpenzime komisionerie biletarie	1,646,684	-
Shp Transport per te trete	739,389	805,910
Taksa antaresimi	721,590	303,553
Sherbime komisione bankare	638,064	371,713
Shpenzime per pritje te tjera	628,324	433,392
Mirembajtje automjete	541,117	294,195
Shpenzime telefoni celulare	461,576	1,112,681
Shpenzime marketingu	408,002	977,216
Shpenzime te tjera	6,446,054	2,515,613
Totali	16,718,412	10,639,034

16. SHPENZIME FINANCIARE

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë, te cilat me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si me poshte:

Përshkrimi i llogarive	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
(Shpenzime)/Te ardhura interesi qera fin.	(454,008)	(544,040)
(Shpenzime)/Te ardhura nga KK per Hua	67,783	516,187
Totali	(386,225)	(27,853)

SPIRIT TRAVEL & TOURS SH.P.K.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

17. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Ne perputhje me ligjet tatimore shqiptare, norma e aplikueshme per tatimin mbi fitimin per periudhen 2016 eshte 15% (31 dhjetor 2015: 15%)

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit, por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimi jane vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Shoqeria per vitin 2016 rezulton me fitim si per qellime kontabile ashtu dhe per qellime fiskale. Nje rikonsilim i tatim fitimit paraqitet si me poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Fitimi i periudhes	4,205,026	126,884
Rregullime per:		
Shpenzime te pazbritshme	2,966,236	964,463
Fitimi fiskal	7,171,262	1,091,347
Shpenzimi tatim fitimit (15%) (2015: 15%)	(1,075,689)	(163,702)
Fitimi kontabel per periudhen	3,129,337	(36,818)

Rakordimi i normes efektive te tatim fitimit:

	31 dhjetor 2016	%	31 dhjetor 2015	%
Fitimi per vitin	4,205,026	100.00%	126,884	100.00%
Tatim fitimi me normen e aplikueshme	630,754	15.00%	19,033	15.00%
Shpenzime zhvleresimi (provizione)	-	0.00%	-	0
Shpenzime te tjera	444,935	10.58%	144,669	114.02%
Totali	1,075,689	25.58%	163,702	129.02%

18. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Me 31 dhjetor 2016, Shoqeria nuk ka çeshtje te cilat do te kene efekte negative ne pozicionin financiar te Shoqeria ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Gjithashtu, me 31 dhjetor 2016, Shoqeria nuk ka angazhime kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

19. NGJARJE TE MEPASSHME

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.